



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:206742

Datë: 31.03.2023

Numri i dokumentit: 04144793

C.nr.2477/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Nexhat Qallapeku, në çështjen kontestimore të paditësit B.N, nga, Rruga "B.M", përfaqësuar nga Ibrahim Z. Dobruna, avokat në Glllogoc, Rruga "Rasim Kiqina" numër 1, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës - Forca e Sigurisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti Kompensim dëmi, vlera e kontestit 13,580.37€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të datës 06.12.2022, të mbajtur me prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 31.03.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.N nga
- II. DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës - Forcat e Sigurisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, që emër të dëmit të material dhe jo material lidhur me lëndimin në punë, të datës 23.11.2015, paditësit t'i paguaj shumat si vijon:

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej..... 1400.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej 980.00€
- Për shëmtim trupor, shumën prej 2,200.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej 150.00€

- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej 210.00€
 - Për shpenzime materiale për shërim, shumën prej 230.37€
- III. DETYROHET e paditura që prestimet si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, paditësit t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, dhe atë për dëmin material nga data e shkaktimit të dëmit, 23.11.2015, kurse për dëmin jo material nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, 31.03.2023, e deri në pagesën e tërësishme, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.
- IV. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumat e aprovuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: në emër të dëmit jo material për dhimbje trupore - fizike shuma prej 2,100.00€, për friken e pësuar shuma prej 2,020.00€, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shuma prej 1,000.00€, për shëmtim trupor shuma prej 2,800.00€, dhe në emër të dëmit material për kujdes të personit të huaj shuma prej 290.00€ dhe për rehabilitim dhe terapi fizioterapeutike shuma prej 200.00€.
- V. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,412.40€ (njëmijë e katërqind e dymbëdhjetë euro e dyzet centë), në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim. Refuzohet kërkesa e paditësit për njohjen e shpenzimeve mbi shumën e gjykuar, në shumë prej 2,176.44€ (dymijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e dyzet e katër centë).

A r s y e t i m

Paditësi, përmes përfaqësuesit të tij, me datë 20.10.2016, në këtë gjykatë, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës - Forcat e Sigurisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi.

Paditësi, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, në padi, seancat gjyqësore dhe fjalën përfundimtare, ka theksuar se është i punësuar tek e paditura, në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Me datë 23.11.2023, ishte i caktuar në shërbim kujdestarie (roje) në Kazermën e Forcës së

Sigurisë në Pomozetin. Pas përfundimit të ndërrimit, paditësi kishte shkuar në vendpushim, brenda objektit të të paditurës, në dhomën numër 3, në të cilën xhami i dritares ishte i thyer disa muaj më parë. Paditësi kishte përjetuar makth në gjumë, me çka ishte ngritur nga krevati dhe i ishte afruar dritares për ajrosje, kur edhe ka rënë në kontakt me xhamin e thyer, duke prerë duart dhe krahët, me ç'rast përjeton dhimbje, si rrjedhojë lëvizë i çorientuar, kur edhe thyen xhamin tjetër të dritares dhe më pas nga dritarja bije në katin për dhese. Nga kolegët i është ofruar ndihmë dhe dërguar në Emergjencë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Ka shtuar se e paditura mban përgjegjësi për dëmin e pësuar paditësi, mbi bazën e përgjegjësisë objektive lidhur me sendin e rrezikshëm. Mbi bazën e kësaj, i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta detyrojë të paditurën që t'ia kompensojë dëmin si në vijim: në emër të shkakimit të dhimbjeve fizike shumë prej 3,500.00€; në emër të frikës së përjetuar shumë prej 3,000.00€; në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumë prej 1,000.00€; në emër të shëmtimit trupor shumë prej 5,000.00€, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 150.00€; në emër të ndihmës nga personi i tretë shumë prej 500.00€; në emër të rehabilitimit dhe terapisë fizioterapeutike shumë prej 200.00€ dhe në emër të shpenzimeve materiale të shërimit shumë prej 230.37€, apo shumë e përgjithshme prej 13,580.37€, me kamatë ligjore.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë të përgjithshme prej 3,588.64€ dhe atë: 208.00€ për këshilla juridike për klientin, 104.00€ për kërkesë për kompensim të dëmit, 208.00€ për përpilim të padisë, 104.00€ për propozim për marrjen e provës me ekspertizë nga lëmi Mbrojtja dhe Siguria në Punës, 208.00€ për precizim të kërkesëpadisë, 1,486.00€ për përfaqësimin e paditësit në 6 seanca gjyqësore (5 seanca të mbajtura nga 270.40€ dhe 1 seancë gjyqësore të shtyrë pa fajin e avokatit), 405.60€ për mungesë të avokatit nga zyra në periudhat kohore të caktuara për mbajtje të seancave gjyqësore, 162.54€ për përfaqësim shqarim gjyqësor – përdorim të automjetit personal, 101.50€ për taksë gjyqësore për padi dhe shërbime bankare, 451.00€ për ekspertiza mjeko ligjore dhe shërbime bankare dhe 151.00€ për ekspertizë nga lëmi Mbrojtja dhe Siguria në Punës dhe shërbime bankare.

E paditura, përmes përfaqësueses së saj, në përgjigje në padi, seanca gjyqësore dhe fjalën përfundimtare, e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit me pretendimin se e paditura me kohë dhe përgjegjësi ka trajtuar rastin e paditësit, duke i ofruar paditësit ndihmën e nevojshme mjekësore si dhe mbështetjen me të gjitha kapacitetet e saj që ka disponuar, duke e dërguar të njëjtin në Qendrën Klinike Universitare, nga e cila është liruar pas tri ditësh, dhe ka vazhduar me pushim mjekësor. Ka shtuar se shpenzimet e shërimit paditësi i ka marr përsipër pa

pëlqimin e të paditurës. Mbi bazën e kësaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve, ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Kontratën e punësimit të datës 14.06.2010, Fletë lëshimin e datës 26.11.2015, me numër të amezës 9459, lëshuar nga Klinika e Kirurgjisë Vaskulare, Raportet nga konsultat mjekësore të datave 28.11.2015, 14.12.2015, 16.12.2015, 31.12.2015, të datës 06.01.2016 me numër të protokollit 48, të datës 12.02.2016 me numër të protokollit 776, të datës 20.01.2016 me numër të protokollit 277, Raportin e datës 17.12.2015 me numër 0701./2442, Raportin mjekësor të datës 10.10.2016 të lëshuar nga “Kavaja Hospital”, rekomandimet për pushime mjekësore të datës 10.03.2016, me numër protokolli 253, të datës 26.03.2016 me numër protokolli 259, Vërtetimet për pushime mjekësore: numër 07 të datës 08.01.2015, numër 981 të datës 18.12.2015, numër 233 të datës 16.03.2016, me numra 243, 244, 245, 246, 247 dhe 248, të gjitha të datës 17.03.2016, Kuponët fiskal: numër 4, 11, të datës 24.11.2015, numër 17, 27, 43 të datës 25.11.2015, numër 0217 të datës 26.11.2015, numër 1, 3, të datës 28.11.2015, numër 1 të datës 30.11.2015, numër 9 të datës 09.12.2015, numër 24 të datës 23.12.2015, numër 0007 të datës 04.02.2016, numër 0030 të datës 17.06.2016, numër 40 të datës 05.02.2016, numër 3 dhe 95 të datës 10.10.2016, Ekspertizën nga Mbrojtja dhe Siguria në punë të datës 09.06.2021 dhe plotësimin e datës 04.05.2022, punuar nga eksperti Ramadan Geci, si dhe Ekspertizën mjekësore nga lëmi i Neurokirurgjisë, Kirurgjisë Plastike dhe Psikiatrisë, punuar me datë 09.06.2021, nga ekspertët Dr. Adem Kllokoqi – Ekspert i Kirurgjisë Plastike, Dr. Armend Kërveshi – Ekspert i Neurokirurgjisë dhe Nazmie Musliu – Eksperte Psikiatre.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (LPK), e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, dhe se në ambientet e të paditurës, në Kazermën e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Pomozetin, përkatësisht në dhomën numër tre, kati për dhese, të cilën e përdornin të punësuarit e të paditurës, përfshirë edhe paditësin, për pushim, para datës së shkaktimit të lëndimit të paditësit kishte dritare me xham të thyer.

Po ashtu mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi me datë 23.11.2015 kishte qenë në vendin e tij të punës dhe se pas përfundimit të shërbimit të rojës, i njëjti kishte shkuar në dhomën numër tre për të pushuar, në të cilën kishte pësuar lëndime trupore.

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues as fakti se lëndimet e paditësit ishin lëndime në punë dhe si shkak i xhamit të thyer dhe rënies së tij nga dhoma numër tre, kati përdhese, në hapësirat e jashtme të objektit, për të cilat lëndime paditësi është trajtuar Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Duke qenë se në rastin konkret nuk ishte kontestues fakti i lëndimit të paditësit në punë, me propozimin e palës paditëse me qëllim që të vërtetohen lëshimet eventuale të ndërgjyqësve në shkaktimin e aksidentit, Gjykata ka bërë nxjerrja e provës me ekspertizë nga lëmia e sigurisë në punë.

Eksperti Ramadan Geci, në ekspertizën e datës 09.06.2021, plotësimin e ekspertizës së datës 04.05.2022 si dhe sqarimeve në seanca gjyqësore, ka konstatuar se me datë 23.11.2015, pas përfundimit të shërbimit të rojës, ora 19:00, paditësi së bashku me kolegët e tij shkon për të pushuar në dhomën numër 3, e cila gjendet në katin përdhese, në objektin e të paditurës, e cila kishte dritare dy kraheshe, me dy palë xhama. Kapaku i djathtë i dritares kishte pjesërisht të thyer xhamin e brendshëm, i thyer muaj më parë. Paditësi, rreth orës 21:30, pëson ankth dhe ka lëvizur në dhomë, me dritë të fikur. Duke mos parë mirë, i është ofruar dritares, ka rënë në kontakt me një pjesë të xhamit të mbetur në dritare, me ç'rast ka prerë duart dhe krahët. Në atë gjendje, duke vepruar me presion të lartë, ka shtyrë xhamin e dytë, të të njëjtës dritare, të cilin nuk ka qenë i thyer, të njëjtin e thyen dhe del jashtë. Eksperti ka shtuar se shkaktar i aksidentit ka qenë ankthi, mos ndërmarrja e masave nga punëdhënësi për parandalimin e rreziqeve, kushtet e rënda të cilat kanë mbizotëruar në dhomën numër 3 si dhe ajrimi jo i mjaftueshëm. Eksperti ka ardhur në përfundim se e paditura mban përgjegjësi primare për lëndimin në punë të punëmarrësit të saj, nga se bazuar në ligjin në fuqi, e paditura është dashtë që të precizoj obligimet e punëmarrësit që dalin nga direktiva dhe legjislacioni. Eksperti në mendimin e tij ka konstatuar se paditësi, lidhur me lëndimin e tij, sa i përket sigurisë dhe shëndetit në punë, nuk mban përgjegjësi.

Gjykata, ekspertizën nga mbrojtja dhe siguria në punë e ka pranuar në tërësi si të besueshme pasi që pala paditëse nuk ka pasur vërejtje në të, ndërsa pala e paditur edhe pse e ka kontestuar, nuk ka kërkuar sqarime nga eksperti, nuk ka parashtruar pyetje në drejtim të ekspertit, dhe se gjykatës nuk i ka propozuar marrjen e ndonjë prove të re, me ekspert tjetër apo grup të ekspertëve.

Nga fletëlëshimi i datës 26.11.2015, me numër të amzës 9459, lëshuar nga Klinika e Kirurgjisë Vaskulare, gjykata ka provuar faktin se paditësi si pasojë e lëndimit në vendin e punës, ka kërkuar ndihmë mjekësore në këtë institucion dhe ka qëndruar i hospitalizuar nga data 23.11.2015 deri me datë 26.11.2015, ku edhe ka pranuar trajtim mjekësor dhe përdorur terapi përkatëse.

Nga raportet e konsullatave të datave 28.11.2015, 14.12.2015, 16.12.2015, 31.12.2015, të datës 06.01.2016 me numër të protokollit 48, të datës 12.02.2016 me numër të protokollit 776, të datës 20.01.2016 me numër të protokollit 277, Raporti i datës 17.12.2015 me numër 0701./2442 dhe Raporti mjekësor të datës 10.10.2016 të lëshuar nga “Kavaja Hospital”, gjykata ka provuar faktin se paditësi edhe pas përfundimit të hospitalizimit ka vazhduar me trajtimin e lëndimeve të pësuar me datë 23.11.2015.

Nga rekomandimet për pushime mjekësore të datës 10.03.2016, me numër protokollit 253, të datës 26.03.2016 me numër protokollit 259, Vërtetimet për pushime mjekësore: numër 07 të datës 08.01.2015, numër 981 të datës 18.12.2015, numër 233 të datës 16.03.2016, me numra 243, 244, 245, 246, 247 dhe 248, të gjitha të datës 17.03.2016, Kuponët fiskal: numër 4, 11, të datës 24.11.2015, numër 17, 27, 43 të datës 25.11.2015, 0217 të datës 26.11.2015, numër 1, 3, të datës 28.11.2015, numër 1 të datës 30.11.2015, numër 9 të datës 09.12.2015, numër 24 të datës 23.12.2015, numër 0007 të datës 04.02.2016, numër 0030 të datës 17.06.2016, numër 40 të datës 05.02.2016, numër 3 dhe 95 të datës 10.10.2016, gjykata ka provuar faktin se paditësi, si pasojë e lëndimit në punë të datës 23.11.2015, ka shfrytëzuar pushim mjekësor për 27 ditë, të vlerësuara nga e paditura si lëndim në punë.

Nga kuponët fiskal me numër 4, 11, të datës 24.11.2015, numër 17, 27, 43 të datës 25.11.2015, 0217 të datës 26.11.2015, numër 1, 3, të datës 28.11.2015, numër 1 të datës 30.11.2015, numër 9 të datës 09.12.2015, numër 24 të datës 23.12.2015, numër 0007 të datës 04.02.2016, numër 0030 të datës 17.06.2016, numër 40 të datës 05.02.2016, numër 3 dhe 95 të datës 10.10.2016, gjykata ka provuar faktin se paditësi si pasojë e lëndimeve të pësuar, ka pasur shpenzime të shërimit në shumë të përgjithshme prej 230.37€.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve të paditësit, nga lëndimi i datës 23.11.2015, me propozimin e palës paditëse, Gjukata ka nxjerrë provën me ekspertiza mjekësore, me ekspertë nga lëmi i Neurokirurgjisë, Kirurgjisë Plastike dhe Psikiatrisë, punuar me datë 09.06.2021, nga ekspertët Dr. Adem Kllokoqi – Ekspert i Kirurgjisë Plastike, Dr. Armend Kërveshi – Ekspert i Neurokirurgjisë dhe Nazmie Musliu – Eksperte Psikiatre.

Eksperti i Kirurgjisë Plastike Dr. Adem Kllokoqi dhe eksperti i Neurokirurgjisë Dr. Adem

Klllokoqi, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit B.N, kanë konstatuar se paditësi, si pasojë e lëndimit të tij në vendin e punës, datë 23.11.2015, ka pësuar lëndime trupore, që cilësohen si lëndime të lehta trupore. Paditësi ka pësuar këto lëndime trupore: Cikatriks hipertorik në regjionin e fytyrës dhe buzës së sipërme, në anën e djathtë; Cikatriks hipertofika në regjionin e krahut dhe parakrahut të dorës së djathtë, në faqen e pasme të saj; Cikatriks në regjionin e nyjeve R/C të dorës së djathtë; Cikatriks në shuplakën e dorës së majtë dhe gishtat e IV dhe V të dorës së djathtë; Humbje e forcës muskulare të dorës së djathtë. Ekspertët kanë konstatuar se tek paditësi është gjetur dëmtim i lehtë i fijeve sensitive të nervave ulnar dhe radial djathtas, për shkak të lëndimit të muskujve. Si pasojë e këtyre lëndimeve, paditësi ka pësuar dhimbje dhe atë: Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 30 minuta, nga koha e lëndimit e deri në dërgimin në Qendrën Emergjente. Dhimbje me intensitet të rëndë në kohëzgjatje prej 3 ditësh, kohë pas kohe deri në veprimin e terapisë kundër dhimbjeve. Paditësi ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 14 ditëve, për shkak të mjekimit të plagëve, kurse dhimbje me intensitet të ulët ka edhe tani, në ndryshime klimatike dhe në sforcime fizike. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, ekspertët kanë konstatuar se ka qenë e nevojshme e në kohëzgjatje prej 30 ditësh, e cila ka konsistuar në përgatitjen dhe ofrimin e ushqimit, mbajtjes së higjienës, veshmbathjes e të tjera. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 30 ditë, ushqim i pasur me proteina, minerale dhe vitamina, ushqim më i përforcuar se ai i zakonshme. Ekspertët kanë konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik në periudhë kohore prej 28 ditë, brenda dy muajve pas lëndimit. Ekspertët kanë konstatuar se paditësi, si pasojë e lëndimit, ka pasur shëmtim trupor të shkallës së mesme, shëmtim ky për shkak të vrrajave, në regjionin mental me gjatësi 2.5cm, parakrahu i djathtë, vrrajë me gjatësi 7x1.5 cm dhe vrrajë tjetër 10 x 1.5 cm, pjesa anterior, gjerësa pjesa posteriore e parakrahut të djathtë vrrajë 6x2cm, krahu i majtë pjesa posteriore 9x1.5 cm dhe tjetëra 8x1cm, vrrajet në kofshën e djathtë katër dhe atë dy me gjatësi 3x0.5 cm dhe dy të tjera me gjatësi 2x0.5 cm. Ekspertët kanë konstatuar se paditësi nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor.

Eksperti i psikiatrisë, Dr. Nazmie Musliu, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi B.N, si pasojë e lëndimit në punë, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare ka përjetuar rreth 1 minutë, si frikë nga kërcënimi i drejtpërdrejtë për integritet të tij fizik, e shfaqur nga momenti i rikthimit të vetëdijes, pas rënies në tokë dhe parë gjendjen e tij të gjakosur. Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 ditëve, në formë të frikës nga invaliditeti i përhershëm dhe pasojat e lëndimit, rikujtimeve të ngjarjes traumatike,

çrregullimit të gjumit, vështirësive të adaptimit me kushtet e trajtimit mjekësor dhe stresit intensiv. Frikë të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 1 muaj, e shoqëruar me ankthe, pasiguri, frikë dhe brengë për ecurinë e mjekimit, kurse frikë sekondare të intensitetit të ulët ka përjetuar në kohëzgjatje prej 5 muajve, e shoqëruar me ankthe, mungesë disponimi, brengës, shqetësimeve gjatë gjumit, për çka edhe është trajtuar nga ana e psikiatrit dhe ka marr terapi përkatëse.

Gjykata ekspertizat mjekësore nga lëmi i Neurokirurgjisë, Kirurgjisë Plastike dhe Psikiatrisë, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që e njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, po ashtu e punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Duke u bazuar në faktet e vërtetuara, gjykata gjeti se në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (LP) dhe Ligjit NR. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve (LMD), të cilat ligje kanë qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko – detyrimor.

Me nenin 60, paragrafi 1, të LP-së është përcaktuar se “punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së punës, t’ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme.”

Me nenin 136 të LMD-së është përcaktuar se “kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji. Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj.”

Me nenin 137 të LMD-së është përcaktuar se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).”

Me dispozitën e nenit 154 të LMD-së është përcaktuar se “dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.”, ndërsa me dispozitën e nenit 155 të ligjit të njëjtë është përcaktuar se “për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të.”

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo sepse nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, provave të administruara, është provuar fakti se me datë 23.11.2015, në objektet e të paditurës, përkatësisht në hapësirat ku ka qenë i angazhuar – punësuar paditësi, në Kazermën e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në Pomozetin, dhoma numër 3, kati përdhese, paditësi ka pësuar lëndime trupore. Këto lëndime, bazuar në konstatimet e ekspertit nga mbrojtja dhe siguria në punë, janë si shkak i mos ndërmarrjes së masave nga punëdhënësi për parandalimin e rreziqeve, duke e ditur se në dhomën numër 3, xhami i brendshëm i dritares, ka qenë i thyer muaj më parë dhe një pjesë e xhamit të thyer ka mbetur në dritare, si dhe për shkak kushteve të rënda, të cilat kanë mbizotëruar në dhomën numër 3 si dhe ajrimi jo i mjaftueshëm, dhe se këto lëshime i atribuohen të paditurës, ndërsa paditësi lidhur me lëndimin e tij, sa i përket sigurisë dhe shëndetit në punë, nuk mban përgjegjësi. E paditura, në raportet e saja zyrtare, lëndimin e paditësit e ka pranuar si lëndim në punë. Andaj, gjykata ka gjetur se pala e paditur si punëdhënëse është përgjegjëse për kompensimin e dëmit paditësit në bazë të përgjegjësisë objektive të paraparë me nenet 173 dhe 174 të LMD-së, lidhur me nenin 60 të LP-së, dëm ky i pësuar pa fajin e paditësit, në vendin e tij të punës.

Gjykata, në këtë procedurë, ka provuar faktin se e paditura nuk ka përmbushur obligimet nga neni 42, paragrafi 2, i LP-së, ku është përcaktuar se “Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin.”. E paditura, nuk ka ofruar prova që do të dëshmonin se e nuk mban përgjegjësi për kompensimin e dëmit, e që do të kishin si pasojë lirimin nga përgjegjësia e të paditurës konform nenit 177 të LMD-së, lidhur me nenin 322.3 i LPK-së.

Gjykata, mbi bazën e gjendjes faktike të provuar si më lartë dhe dispozitave ligjore të sipërcituara, pas vlerësimit të të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jomaterial, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditësit, vlerësimit të ekspertizave mjekësore, miratoj pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, në vlerën e shpërblimit të dëmit si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, në emër të dhimbjeve fizike, aprovoi kërkesëpadinë e paditësit në shumë prej 1,400.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza mjekësore nga lëmi i Kirurgjisë Plastike dhe Neurokirurgjisë është provuar se paditësi, si pasojë e lëndimit të datës 23.11.2015, kishte pësuar lëndime të lehta trupore, e që ishin: cikatriks hipertorik në regjionin e fytyrës dhe buzës së sipërme, në anën e

djathtë; Cikatriks hipertofika në regjionin e krahut dhe parakrahut të dorës së djathtë, në faqen e pasme të saj; Cikatriks në regjionin e nyjeve R/C të dorës së djathtë; Cikatriks në shuplakën e dorës së majtë dhe gishtat e IV dhe V të dorës së djathtë; Humbje e forcës muskulare të dorës së djathtë, si dhe dëmtim i lehtë i fijeve sensitive të nervave ulnar dhe radial djathtas, për shkak të lëndimit të muskujve. Si shkak i këtyre lëndimeve, paditësi kishte përjetuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 30 minutave, dhimbje të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 3 ditëve, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 14 javë, kurse dhimbjet me intensitet të ulët vazhdon të ketë ende, në ndryshime klimatike dhe sforcime fizike.

Në emër të kompensimit lidhur me frikë, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 980.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza nga lëmi i psikiatrisë është provuar se paditësi, si pasojë e lëndimit të datës 23.11.2015, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare në kohëzgjatje prej 1 minuti, ndërsa sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 2 ditësh, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 1 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët ka zgjatur për 5 muaj.

Në emër të dhembjeve shpirtërore për shkak të shëmtimit trupor, gjykata ka caktuar dëmshpërblimin në shumë prej 2,200.00€, duke pasur parasysh moshën e paditësit, vendin dhe shkallën e shëmtimit të pësuar në lëndimin e datës 23.11.2015, shëmtim ky i konstatuar me ekspertizën mjekësore, i cili sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertit mjekësor, rezulton të jetë i shkallës së mesme, në regjionin e parakrahut të djathtë, pjesa anterior dhe pjesa posteriore si dhe në kofshën e djathtë.

Gjykata, vlerëson se shumat e kompensimit për dëmin jomaterial, të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të dëmshpërblimit, do t'i mundësoj paditësit si satisfaksion që të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensoj të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, si dhe duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të pësuar, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe shkallën e shëmtimit trupor. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës, qëllimit të cili i shërben ky kompensim, siç përcaktohet me nenin 183 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, si dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës për caktimi e kriterëve orientuese dhe lartësinë e shpërblimit të drejtë të dëmit jomaterial.

Gjykata, në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar, ndihmë e kujdes të huaj, dhe shpenzimet e shërimit, ka aprovuar shumat si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 179, paragrafi 1 të Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, ku është përcaktuar se “kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.” Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensim të këtij lloji të dëmit material, për ushqim të përforcuar dhe kujdesin e huaj, përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk kanë prezantuar prova konkrete materiale. Gjykata, vlerëson se paditësit i takon ky kompensim, duke u bazuar edhe në praktikën e gjertanishme gjyqësore, ku është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve, palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi për këtë lloj kompensimi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar, i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete.

Gjykata, në emër të ushqimit të përforcuar, ka caktuar kompensimin në shumën prej 150.00€, brenda kufijve të kërkesës së palës paditëse, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse nga ekspertiza mjekësore është provuar fakti se paditësi, si pasojë e lëndimit të datës 23.11.2015, ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, në kohëzgjatje prej 30 ditëve.

Në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë, gjykata ka caktuar kompensimin në shumën prej 210.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, nga se nga ekspertiza mjekësore është provuar fakti se paditësi, ka pasur nevojë për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë në kuptim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor si në përgatitjen dhe ofrimin e ushqimit, mbajtjes së higjienës dhe veshmbathjes, në kohëzgjatje prej 30 ditëve.

Gjykata, në emër të dëmit material për shpenzimet e shërimit, ka gjykuar shumën prej 230.37€, pasi që nga provat e administruara në këtë çështje juridike, dhe atë kuponët fiskal me numër 4, 11, të datës 24.11.2015, numër 17, 27, 43 të datës 25.11.2015, 0217 të datës 26.11.2015, numër 1, 3, të datës 28.11.2015, numër 1 të datës 30.11.2015, numër 9 të datës 09.12.2015, numër 24 të datës 23.12.2015, numër 0007 të datës 04.02.2016, numër 0030 të datës 17.06.2016, numër 40 të datës 05.02.2016, numër 3 dhe 95 të datës 10.10.2016, është provuar fakti se paditësi ka krijuar shpenzime të shërimit në lartësi të përgjithshme prej 230.37€.

Gjykata, ka vendosur si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit që ndërlidhet me dëmin jomaterial, pasi që vlerësoj se kompensimi

përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë. Kurse sa i përket dëmit material, gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përket kujdesit të personit të huaj në shumë prej 290.00€, nga se në vlerësimin e gjykatës shumat e gjykuara për kategorinë e kompensimit për kujdes të personit të huaj janë në harmoni me qëllimin e kompensimit dhe praktikën gjyqësore për këtë lloj kompensimi. Ndërsa sa i përket kompensimit të dëmit material për rehabilitim fizioterapeutik, gjykata, bazuar në nenin 322 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ka refuzuar kërkesëpadinë në shumë prej 200.00€, sepse nuk janë ofruar prova mbi bazën e të cilave do të provoheshin shpenzimet e bëra për qëllime të këtij kompensimi të pretenduar.

Gjykata i ka vlerësuar si të pa bazuar pretendimet e të paditurës se shpenzimet e shërimit paditësi i ka marr përsipër pa pëlqimin e të paditurës, nga se në rastin konkret është provuar fakti se shpenzimet e krijuara nga paditësi kanë lidhje kauzale me lëndimin e tij në punë dhe se paditësi nuk ka pasur ndonjë obligim ligjor që të kërkojë pëlqimin e të paditurës për krijimin e shpenzimeve të shërimit. Për më tepër, e paditura, në kuptim të nenit 60 të LP-së, është e obliguar që t'i mbulojë shpenzimet e lëndimit të paditësit në punë, e të cilat shpenzime, bazuar në provat e administruara në këtë çështje juridike, janë në shumë prej 230.37€.

Duke qenë se pas administrimit të të gjitha provave, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se të paditësit i takon edhe kamatëvonesa, e përcaktuar me nenin 382 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, sipas të cilit debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8 %) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë. Kamata, për dëmin material fillon të rrjedh nga data e shkaktimit të dëmit, 23.11.2015, ndërsa për dëmin jo material nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, përkatësisht data 31.03.2023, e gjerë në përmbushjen e plotë të detyrimit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore të neneve 449 dhe 452 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe Tarifës së OAK-së, sipas së cilës paditësit i pranohen shpenzimet në shumë të përgjithshme prej 1,412.40€. Shpenzimet e procedurës të njohura paditësit janë: 104.00€ për përpilim të padisë, 608.40€ për përfaqësim e paditësit nga avokati në katër seanca gjyqësore të mbajtura dhe një seancë gjyqësore të shtyrë pa fajin e avokatit (4 seanca nga 135.20€ dhe 1 seancë nga 67.60€) 150.00€ për marrjen e provës me ekspertizë nga lëmi Mbrojtja dhe Siguria në Punë, 450.00€ për marrjen e provës me ekspertizë mjekësore, 100.00€ për taksë gjyqësore për padi dhe 2.00€ për

shërbime bankare për deponim të mjeteve për marrjen e provave me ekspertiza. Shpenzimet e procedurës të njohura në këtë çështje juridike për përpilim të padisë dhe për përfaqësim të paditësit në seancat gjyqësore nga avokati, janë përlllogaritur bazuar në tariforin 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, për vlerat e kontestit deri në 10,000.00€ si dhe nenin 452, paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, pasi që pjesa e aprovuar e padisë është nën vlerën 10,000.00€. Gjykata paditësit nuk i ka njohur shpenzimet e kërkuara mbi shumën prej 1,414.40€ e deri në shumën prej 3.590.84€, duke u bazuar në nenin 453 të LPK-së, ku është përcaktuar se “me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”. Në rastin konkret shpenzimet që nuk i janë njohur palës paditëse janë; 208.00€ për këshilla juridike, 104.00€ për kërkesë për kompensim dëmi, 104.00€ për propozim për marrjen e provës me ekspertizë, 208.00€ për precizimin e kërkesëpadisë, 878.80€ për përfaqësimin e paditësit nga avokati në seanca gjyqësore, 405.60€ për mungesë nga zyra të avokatit, 162.54€ për përdorim të automjetit personal për udhëtim dhe 1.5€ për marrjen e provave me ekspertiza, përkatësisht për shërbime bankare. Gjykata ka refuzuar njohjen e shpenzimeve për Këshilla juridike dhe kërkesë për kompensim dëmi pasi që të njëjtat nuk i përkasin shpenzimeve të krijuara në këtë procedurë kontestimore, përkatësisht shpenzimeve për ndjekjen e çështjes në gjykatë. Gjykata nuk ia njohur palës paditësit shpenzimet për precizim të kërkesëpadisë dhe propozimit për marrjen e provës me ekspertizë nga se nga pala paditëse nuk ka pasur ndryshim të padisë as në aspektin objektiv e as në aspektin subjektiv, kurse sa i përket propozimit për marrjen e provës me ekspertizë, gjykata nuk ka njohur këtë shpenzim nga se një shpenzim i tillë i pretenduar nuk ka qenë i nevojshëm për faktin se propozimi për marrjen e provës me ekspertizë, konform nenit 405 të LPK-së, do të mund dhe duhej të bëhej në seancën përgatitore, të mbajtur me datë 15.02.2021. Gjykata nuk ka njohur shpenzimet e paditësit për përfaqësim në seanca gjyqësore, mbi shumën e aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 452, paragrafi 5 të LPK-së dhe Tarifat e Odës së Avokatëve, pasi që shpenzimet procedurale të pretenduara nga pala paditëse i referohen vlerës së kontestit mbi 10,000.00€, ndërsa gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit nën këtë vlerë si dhe për shkak se seanca e datës 01.11.2022 nuk është mbajtur e as shtyrë por e njëjta është anuluar. Paditësit nuk i janë njohur shpenzimet për mungesë nga zyra të avokatit pasi që në vlerësimin e gjykatës këto shpenzime të pretenduara janë konsumuar me njohjen e shpenzimeve për përfaqësimin e paditësit nga avokati në seancat gjyqësore.

Gjykata nuk ka njohur shpenzimet e procedurës kontestimore për për përdorimin e automjetit personal, bazuar në dispozitën e nenit 463, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, nga se ky shpenzim është shpenzim material, për të cilin pala do të duhej të ofronte prova materiale për shpenzimin e bëra me faturë apo kupon fiskal, çmimin e derivative në ditën e furnizimit, ndërlihdjen e tyre me automjetin që është përdorur dhe këto t'ia dorëzonte gjykatës, e në bazë të kësaj gjykata të vlerësonte shpenzimin e bërë për këtë qëllim. Ndërsa sa i përket shpenzimeve për shërbime bankare për pagesë të taksës gjyqësore për padi, në shumë prej 1.50€, të njëjtat nuk janë provuar.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.2477/16, me datë 31.03.2023

Gjyqtari

Nexhat Qallapeku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të tij, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.